



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Prurur - Prirëtor Më Datë: 29.04.2016			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prirëtor	Vlera Vendimet
02	013/530		

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12. paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 shkronja d) lidhur me nenin 51 paragrafi 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, dhe nenit 36.paragrafi 36.2 shkronja d) lidhur me nenin 47 paragrafi 47.2 të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seance e mbajtur më 27.04.2016, aprovon këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMITETIT PËR BARAZI GJINORE

Neni 1.

Kuvendi i Komunës së Vitisë, APROVON Vendimin për formimin e Komitetit për Barazi Gjinore për Komunën e Vitisë.

Neni 2.

Komiteti për barazi gjinore përbëhet prej 5 anëtarëve, 4 (katër) anëtarë nga Kuvendi i Komunës dhe 1 (një anëtarë nga shoqëria civile dhe atë:

- 1.Ajtene Frangu –anëtare,
- 2.Hyse Rama- anëtare,
- 3.Majlinda Ostragllava –anëtare,
- 4.Vehbi Rama- anëtar,
- 5.Tefik Salihu – anëtar,

Komiteti për barazi gjinore në takimin e parë e emëron Kryesuesin e Komitetit për Barazi Gjinore.

Neni 3.

Komiteti për barazi gjinore, është komitet jo obligativ dhe do të shërbej si trup ndihmëse (plotësuese) e Kuvendit të Komunës dhe mekanizëm rekomandues për organet komunale në fushën e barazisë gjinore.

Neni 4.

Detyrat e këtij komiteti janë të përcaktuara në bazë të Ligjit për vetëqeverisjen lokale dhe Ligjit për Barazi Gjinore.

Neni 5.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës së Vitisë.

Neni 6.

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në Veb faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit,
2. Shërbimit të Kuvendit,
3. Drejtorisë për Shërbime Publike, dhe
4. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

